



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

NJOFTIM MBI PROCEDURAT E STUDENTËVE PËR LEJE QËNDRIMI NË TURQI

Ambasada e Republikës së Turqisë në Tiranë, njofton studentët shqiptarë që do të ndjekin studimet në Turqi se ka nisur procedura për të lehtësuar veprimet për dhënien e lejes së qëndrimit për studentët e huaj.

Sipas kësaj procedure, pa u kërkuar “Vizë arsimore”, do të pranohen aplikimet për leje qëndrimi për:

- Studentët e huaj, që do të shkojnë në Turqi me vizë ose pa vizë, siç parashikohet midis dy vendeve dhe që do të studiojnë në një institucion të arsimit të lartë në Turqi, në nivelet përgatitore, ciklin e parë, master, doktoratë, specializim në mjekësi dhe specializim në stomatologji;
- Studentët e huaj, që do të ftohen në Turqi nga universitete në varësi të institucioneve të arsimit të lartë në kuadrin e programeve ndërkombëtare të shkëmbimit të studentëve dhe atyre kulturore, si dhe programeve arsimore dhe rinore të Bashkimit Evropian.

Pra, për shtetasit e vendeve, me të cilët nuk aplikohet regjimi i vizave dhe që do të studiojnë në Turqi, do të jetë e mjaftueshme, që për të marrë lejen e qëndrimit të aplikojnë pranë Prefekturës përkatëse brenda një muaji nga data e hyrjes së tyre në Republikën e Turqisë.